



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:902012  
Datë: 17.08.2021  
Numri i dokumentit: 02093311

Ac.nr.4472/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi -kryetar i kolegjit, Rustem Thaqi dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, me zyrtaren ligjore Biondina Zeneli, në çështjen juridike -kontestimore të paditësve R.B.1., R.B.2. dhe B.B. të gjithë nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, të cilët i përfaqëson i autorizuari B.N., avokat nga Prizreni kundër të paditurës Kompania e Sigurimit “K...” me seli në Prishtinë, Lagja ....., ..., nr... të cilën e përfaqëson N.B., e punësuar pranë të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 3,100 euro duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.325/17, i datës 24.08.2017, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 04.08.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës Kompania e Sigurimit “K...” me seli në Prishtinë, ..., ... .., nr..., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.325/17, i datës 24.08.2017, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.325/17, i datës 24.08.2017, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që: APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve “K...” nga Prishtina, që t’ua paguajnë paditësve në emër të kompensimit të dëmit sipas këtyre bazave: a) kompensimi i dëmit jo material për dhimbje shpirtërore për shkak të vdekjes së tani të ndjerit A.B., në aksidentin e shkaktuar më 11.10.2015 si vijon: -R.B.1., të atit, shumën prej 6.000 euro; -R.B.2., së ëmës, shumën prej 6.000 euro; dhe -B.B., të vëllait, shumën prej 3.000 euro. Gjithsej duhet paguar sipas kësaj baze shumën prej 15.000 euro, e cila shumë duhet zvogëluar për 20% në emër të kontributit të ndjerit A.B., në shkaktimin e aksidentit, pra për 3000 euro ashtu që gjithsej shuma e kompensimit është 12.000 euro.; b) në emër të kompensimit të dëmit material: -shpenzimet e varrimit dhe ndërtimi i përmendores në shumë prej 800 euro, të gjitha si në pikën a) dhe b) të dispozitivit në shumë prej

12.800 euro, e paditura obligohet t'ua paguajë paditësve, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit me kamatëvonesën e cila do të llogaritet nga dita e marrjes së aktgjykimit. Në pikën II ka vendosur që: OBLIGOHET kompania e paditur që t'ua paguajë paditësve në emër të shpenzimeve të procedurës, shumën prej 1,381.64 euro në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj ashtu që të gjykohet në shumën e ofruar nga e paditura ose të prishet aktgjykimi dhe lënda të kthehet në rivendosje dhe rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk kanë parashtruar paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësuesit të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit së tij, me datë 17.03.2017, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi, të precizuar si në seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilën kanë kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësve për kompensimin e dëmit material dhe jo material, me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.325/17 i datës 24.08.2018, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se nga provat e administruara sidomos nga konstatimet e ekspertëve gjykata konstaton se nuk ekziston përgjegjësi e ndarë në atë përqindje të njëjtë siç e konsideron e paditura sepse në bazë të provave të administruara, vozitësi i autobusit ka ndërmarrë veprime në kundërshtim me rregullat e komunikacionit duke lëvizur me shpejtësi prej 78 km/h, në vendin ku është lejuar shpejtësia prej 50 km/h. Në rastin konkret, vozitësi i automjetit ka ndërmarrë veprimin e tejkalimit të automjetit tjetër para se të bindet më parë se mund të bëjë një veprim të tillë në mënyrë të sigurt. Kjo shkelje e rregullave nga ana e vozitësit të autobusit është aq më e madhe kur ai është vozitës profesional i cili kryen detyrë me përgjegjësi meqë transporton udhëtar. Gjykata e shkallës së parë ka konsideruar se ekziston edhe përgjegjësia e vozitësit të biçikletës sepse ai ka lëvizur në shiritin e kundërt të komunikacionit nga ai i lejuar, pa shenja përkatëse të sinjalizimit dhe sepse ka transportuar personin tjetër në biçikletën pa ulëse të veçantë për atë person, prandaj pjesëmarrja e tij në këtë aksident është 20%.

Gjykata ka vlerësuar se meqenëse paditësit janë prindërit dhe vëllai i të ndjerit, prandaj i takojnë rrethit të ngushtë familjar, të cilëve i takon e drejta për këtë lloj të shpërblimit material. Padyshim se e ëma dhe i ati përjetojnë dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë për shkak të humbjes së fëmijës, e dhimbja e tyre është aq më e madhe për shkak të mënyrës së vdekjes së të birit. Prandaj, mendimi i gjykatës së shkallës së parë është se prindërve u takon shuma prej 6.000 euro, në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara dhe të cilat do të kenë edhe në të ardhmen për shkak të vdekjes së të birit. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka konsideruar se humbja e vëllait paraqet një ngarkesë të madhe emocionale gjatë jetës sepse mungon dashuria e vëllait e kjo shkakton

dhimbje shpirtërore dhe vuajtje shpirtërore, kështu që gjykata ka konsideruar se të vëllait i takon e drejta në kompensim në shumë prej 3.000 euro.

Gjykata e shkallës së parë gjatë caktimit të lartësisë së kompensimit të gjykuar, ka bërë vlerësim të lirë në pajtim me nenin 323 të LPK-së, duke pasur parasysh rrethanat në të cilat është shkaktuar vdekja e tani të ndjerit A., si dhe qëllimin e këtij lloji të kompensimit, pra është fjala për kompensim adekuat sepse dhimbja shpirtërore për anëtarët e familjes nuk mund të matet e asgjë, duke e aprovuar në tërësi konstatimin dhe mendimin e ekspertit të psikiatrisë, si mendim objektiv dhe profesional të bazuar në shkencë. Gjykata e ka zvogëluar shumën e tërësishme në emër të kompensimit të dëmit jo material për shkak të dhimbjeve shpirtërore të paditësve prej 15.000 euro, shumë e zvogëluar për 20% duke konsideruar se me këtë përqindje ka qenë edhe kontributi i të ndjerit A. në shkaktimin e aksidenti, ashtu që sipas këtij lloji të kompensimit shuma e përgjithshme do të jetë 12.000 euro. Meqenëse pala e paditur në tërësi e ka pranuar kompensimin e shpenzimeve të varrimit dhe ndërtimin e përmendores, në shumën e kërkuar gjykata ka gjykuar shumën prej 800 euro.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me kumatën ka vendosur konform nenit 382 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës konform nenit 452 par.2 lidhur me nenin 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se Aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore - LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Në raport me pretendimin ankimor të palës së paditur për kundërshtim të dispozitivit me arsyetim, në raport me paditësin e tretë, si dhe pretendimi për tejkalim të kërkesëpadisë, kjo nuk qëndron, sepse kemi të bëjmë me gabim të natyrës teknike që mund të përmirësohet në çdo kohë, pastaj në aktgjykimin burimor shuma e kompensimit të paditësit të tretë është 3,000.00 euro, pra e njëjtë me shumën e kërkuar nga i autorizuari i paditësve, por me rastin e përkthimit të aktgjykimit, është gabuar në numër në vend të shumës 3,000.00 për paditësin e tretë është shënuar shuma 6,000.00, por që po ashtu edhe në atë vendim në arsyetim shihet qartë se bëhet fjalë për shumën 3,000.00 euro.

Gjykata me rastin e vendosjes për lartësinë e kompensimit drejtë ka vendosur në raport me shumat, andaj pikërisht duke u bazuar në këtë gjykata nuk ndryshoi shumat, por të njëjtat i vërtetoi, por gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vlerësuar dhe konstatuar kontributin e pjesëmarrësve në aksident, pasi që ka konstatuar se kontributi i të ndjerit (A.B.) në aksident ka qenë me 20 %, ndërsa nga ekspertiza e komunikacionit, respektivisht nga veprimet e ndërmarra nga i ndjeri ditën kritike, kontributi i tij do të ishte në një shkallë të përgjegjësisë prej 40 %, pra dhe jo 20 % sikurse është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e as në shkallë prej 50 % sikurse pretendon e paditura.

Nuk mundet me qenë kontributi i të ndjerit në shkallë të njëjtë me kontributin e të siguarit të të paditurës, pasi deri te aksidenti ka ardhur si rezultat i lëshimeve më të mëdha të të siguarit të të paditurës, pasi i njëjti përveç tejkallimit të shpejtësisë së lëvizjes nga 50 km/h sa ka qenë e lejuar, në 78km/h sa ka lëvizur, ka ndërmar veprimin e pasigurt të tejkallimit në mungesë të pasqyrës së qartë të rrugës se a është e lirë a po jo sepse nuk ka pasur ndriçim të mjaftueshëm, ndërsa lëshimet e të ndjerit janë karakterizuar nga fakti se i njëjti ka lëvizur në shiritin e majtë përderisa ka qenë dashur që të ngiste bicikletën në shiritin e djathtë.

Gjykata e Apelit ka marrë për bazë shumat nga 10 000 euro për prindërit dhe 5 000 për vëllaun, krejt kjo duke marrë për bazë mënyrën e shkaktimit të aksidentit, moshën e të ndjerit, qëllimin e kompensimit etj.

Në rastin konkret dhimbjet shpirtërore të prindërve dhe vëllaun të të ndjerit janë konfirmuar edhe me anë të ekspertizës mjeko-ligjore, edhe pse në raste të tilla ekspertizat nuk janë të nevojshme, pasi është fakt notor që nuk ka nevojë të provohet se secili anëtar i familjes ndjen dhimbje për humbje të anëtarit tjetër. Dhimbjet nuk janë të njëjta, në secilin rast, pasi dhimbjet si të tilla, gjatë manifestimit varen edhe nga faktorët tjerë, ku ndonjëherë dinë me qenë më të shfaqura ( me intensitet më të lartë), të lënë pasoja, e sidomos në raste të tilla kur merret lajmi se personi në fjalë që ka qenë në bicikletë si rezultat i aksidentit nuk ka mundur t'i mbijetoj dhimbjeve. Tek anëtarët e familjes (e sidomos tek prindërit) u krijohet/shfaqet një parafytyrim për djalin e tyre të ndjerë, se si ka mundur me qenë goditja që ka rezultuar fatale, e cila ka qenë nga mbrapa, koha se kur ka qarkulluar i ndjeri, vendi i ndodhjes. Të gjitha këto elemente e arsyetojnë lartësinë e marr për bazë nga gjykata e shkallës së dytë. Meqenëse lartësia përfundimtare e kompensimit në emër të dhimbjeve shpirtërore, pas zvogëlimit/zbritjes së shumave në raport me kontributin e të ndjerit arrinte në lartësinë e shumave të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, aktgjykimi nuk u ndryshua, por vetëm gjendja faktike u vërtetua ndryshe në raport me kontributin, ku u arsyetuan faktet vendimtare që i atribuohen përgjegjësisë, shkallës së kontributit, lartësinë e marr për bazë, dhe kompensimin adekuat dhe real.

Një kompensim i tillë në emër të dhimbjeve shpirtërore assesi nuk mund të jetë proporcional me dhimbjen sepse nuk ka çmim që e blen apo kompenson dhimbjen e prindërve për humbjen e fëmijut, e sidomos në moshë të tillë pa i mbushur 20 vite, por një kompensim i tillë është një satisfacion moral, në përputhje me qëllimin e kompensimit. Lartësia e kompensimit është në përputhje të plotë edhe me praktikën gjyqësore në Kosovë.

Baza juridike e kërkesëpadsisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjënë mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”, me nenin 140 të këtij ligji përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se: “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ”.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës edhe pse nuk është përcaktuar me përqindje, meqenëse ka qenë fuqi ligji i ri atëherë dihet mirëfilli se ka qenë lartësia 8%, krejt kjo në pajtim me nenin 382 të LMD-së, e duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 08.11.2016, e deri në

pagesën definitive, sepse paditësi për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tij për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
Ac.nr.4472/18, me datë 04.08.2021

Kryetari i kolegjit  
Faton Ademi